



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/2023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 15.05.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me Nr. të prot.DPKI-3006/25/B, për zyrtarin Lavdim Bajrami, Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa-ZKF në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin Lavdim Bajrami, Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa-ZKF, në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) ka filluar trajtimin e këtij rasti pas pranimit të një raportimit nga jashtë (në vijim: raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit, pjesë nga kërkesa (citojmë): "[...] z.Lavdim Bajrami, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit, rezulton në konflikt të interesi, pas që gjatë periudhës kur unë ushtroja detyrat shtesë si Zyrtare e Autorizuar për Listën e Pagave, ai-i caktuar nga Sekretari si ZKF dhe si Zëvendësues i Zyrtarit të Autorizuar për listën e pagave-ka proceduar pagesa retroaktive së bashku me Sekretarin, pa transparencë dhe pa me përfshirë në komunikim. Si rezultat, kam hasur pagesa të panjohura, ndërkohë që më është thënë se "nuk kam të drejtë të kërkoj dokumentacion, por vetëm të konfirmoj rregullsinë dhe ta dërgoj në Thesar për pranimin e listave finale të pagave dhe procedimin e pagesave në Thesar.

Gjithashtu, nga nëntori 2024 deri me 04.09.2025, në të gjitha email-et e pranuar nga Sekretari për procedim në Thesar, z. Lavdim Bajrami ka qenë i përfshirë në çdo komunikim me email, duke më kërkuar që dokumentacioni të pranohet nga ai dhe më pas të procedohet në Thesar. Sipas Ligjit për Zyrtarë Publik, dosjen e punonjësve duhet të menaxhohet nga Zyra për

Burime Njerëzore dhe nuk duhet të mbahet në Zyrën e Sekretarit për t'u dorëzuar tek z. Bajrami që më pas unë të kërkoj nga ai, duke krijuar një procedurë të panevojshme dhe të papërshtatshme ligjrisht, gjë që nuk është e ligjshme dhe cenon pavarësinë dhe integritetin tim funksional si udhëheqëse e Divizionit për Burime Njerëzore në UShAF.

Mospajtim me z. Lavdim Bajrami gjatë viteve 2023-2024, gjatë ushtrimit të detyrave shtesë në pozitën e Zyrtarit Shpenzues, kam paraqitur disa herë ankesa tek Sekretari për ndërhyrjet e z. Lavdim Bajrami, të cilat përbënin praktika në mos përputhje me rregulloret e Thesarit. Në prezencë të Sekretarit, kam qenë subjekt i ofendimeve dhe kërcënimeve për të vazhduar ushtrimin e këtyre detyrave sipas udhëzimeve të tij, të cilat ishin të pabazuara. Në këtë rast, Sekretari i ka arsyetuar veprimet e tij me shprehjen: "është djalë i ri dhe energjik".

Gjithashtu, me datën 18.09.2025, u kam dërguar emali anëtarëve të Komisionit Disiplinor, znj. Leonora Syejmani dhe z. Lavdim Bajrami, me Kërkesën për shqyrtimin e konfliktit të interesit të anëtarëve të komisionit disiplinor, por nuk është ndërmarr asnjë veprim. [...]

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konform mandatit dhe kompetencave ligjore që i ka sipas Ligjit Nr.08/-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar hetim administrativ duke trajtuar dhe shqyrtuar pretendimet për konflikt të interesit, bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Në pajtim me nenin 22, paragrafin 3, dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit sipas procedurës përmes shkresës zyrtare (DPKI-364/26), ka njoftuar Lavdim Bajrami, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në kuadër të zhvillimit të veprimeve procedurale është mbajtur takim me zyrtarin Lavdim Bajrami, me ç' rast i njëjti është njoftuar me pretendimet e ngritura për konflikt të mundshëm të interesit. Gjatë takimit, ai ka paraqitur argumentet dhe sqarimet e tij lidhur me rastin në fjalë, të cilat më pas i ka përcjellë edhe në formë të shkruar në Agjenci.

Nga deklaratat në takim dhe të dërguar përmes emailit në Agjenci, Lavdim Bajrami subjekt i trajtimit për konflikt të interesit, lidhur me çështjen e ngritur për konflikt të interesit ndër të tjera ka deklaruar (*citohet pjesë relevante nga deklarata*): "[...] Më datë 27.01.2023 jam caktuar, me autorizim nga Sekretari, në formularin standard të Thesarit të Kosovës, si autorizues i listës së pagave. Ndërsa nga data 15.05.2023, si zyrtare e autorizuar është caktuar znj. Rreba Selimi, ndërsa unë nga kjo datë jam caktuar si zëvendës-autorizues i listës së pagave. Znj. Rreba ka vazhduar punën e saj si autorizuese e listës së pagave, ndërsa në mungesë të saj unë në cilësinë e zëvendës-autorizuesit, kam dërguar materialet e nevojshme në Thesar, në përputhje me autorizimin përkatës.

Sa i përket pretendimit të saj se nuk e kam vendosur në "Cc" në e-mail-et e dërguara në Thesar, sqaroj se ajo shpesh ka hezitur t'i kryej detyrat që i takojnë. Në disa raste, ajo ka dërguar materialet në Thesar vetëm pasi ka marrë ndihmë nga ne, duke deklaruar: "Unë nuk di të kalkuloj, edhe pse është punë e imja".

Ne i kemi sqaruar vazhdimisht se çdo ndryshim i dërguar në Thesar nuk mund të pranohet pa aprovimin tim si ZKF dhe aprovimin e ZKA-së. Për këtë arsye, i është kërkuar që fillimisht të rregullojë listën retroaktive, dhe më pas ta shqyrtojë së bashku para se të dërgohet në Thesar,

në mënyrë që çdo parregullsi të korrigohet ose të mos procedohet pa u plotësuar dokumentacioni i nevojshme. [...] Sa i përket mos vendosjes së saj në "Cc", kjo ka ndodhur për arsye se ajo nuk ka pranuar të rregulloj kalkulimet ne listën retroaktive dhe nuk ka qenë pjesë e përgatitjes së dokumentacionit. Praktika e vendosjes në "Cc" zbatohet për zyrtaret që kanë kontribuar ne përgatitjen e dokumenteve, ndërsa jo për ata që nuk kanë pasur rol në to. Gjithsesi, zyrtarët relevant, përfshirë ZKA-në dhe Prorektorin për Financa, janë vendosur vazhdimisht në "Cc" për shkak të pozitës dhe përgjegjësive të tyre menaxheriale.

[...] Sa i përket pretendimit se unë e kam ofenduar znj. Rreba Selimi në prezencë të Sekretarit, kjo është plotësisht e pavërtetë dhe përbën një shpifje të rëndë ndaj meje. Si person dhe në aspektin profesional, nuk kam ofenduar asnjëherë asnjë kolegë, e aq më pak një kolege. Nëse një e gjë e tillë do të kishte ndodhur, lind pyetja: ku është ankesa e saj, me çfarë date është protokolluar dhe ku gjendet ajo? Unë nuk jam njoftuar asnjëherë për ndonjë ankesë të tillë dhe nuk kam qenë subjekt i ndonjë mase disiplinore për një pretendim të tillë.

Në institucionin tonë funksionon Këshilli i Etikës, dhe në rast të një ankese të tillë, unë do të mbaja përgjegjësi në përputhje me rregulloret ne fuqi. Prandaj, këto pretendime nuk kanë bazë faktike dhe nuk mbështeten me asnjë provë. Këto akuza janë ngritur vetëm pas faktit që unë, në cilësinë e kryetarit të një komisioni të rregullt në UShAF, i caktuar me vendim, e kam ftuar znj. Rreba Selimi në një seancë disiplinore. Që nga ajo kohë, ajo ka ndërprere komunikimin me mua.

Deri në atë moment, kemi pasur marrëdhënie korrekte kolegjale dhe, siç u përmend më lartë, i kemi ofruar mbështetje të vazhdueshme, duke marrë parasysh edhe gjendjes e saj shëndetësore, sipas deklarimeve të saj. Pavarësisht sjelljeve të saj të fundit, ne kemi vazhduar të mbajmë një qasje profesionale dhe korrekte. Deklaroj se nga ana ime nuk ka pasur dhe nuk ka raporte armiqësore me znj. Rreba Selimi. Raporti im ndaj saj ka qenë dhe mbetet korrekt në kuadër të marrëdhënieve kolegjale[...]"

Pas administrimit të provave relevante, përfshirë informatat e pranuar nga raportuesi i rastit, deklaratat dhe sqarimet e dhëna nga zyrtari Lavdim Bajrami, si dhe dokumentacionin tjetër përcjellës të siguruar gjatë zhvillimit të procedurës së hetimit administrativ, janë konstatuar këto fakte dhe prova si në vijim:

- Vendimi Nr. 2728/25, të datës 27.08.2025, me të cilin Sekretari i Përgjithshëm i UShAF, ka formuar komisionin disiplinor për shqyrtimin e rasteve në procedurë disiplinore për stafin administrativ të UShAF, me mandat dy vjeçar;
- Fletëparaqitja e datës 28.08.2025, nr. 2744/25, nga Sekretari i Përgjithshëm drejtuar Komisionit Disiplinor të Administratës së Përgjithshme, për Lendita Rreba Selimi për shkelje të rëndë disiplinore "moskryerje të detyrave të punës", sipas kontratës dhe akteve nënligjore në fuqi dhe "mosbindje ndaj urdhrave të eprorit";
- Ftesa e datës 18.09.2025, nr. 3145/25, nga kryetari i komisionit disiplinor, për Lendita Rreba Selimi për paraqitjen ne seancë disiplinore, me qëllim të konstatimit të fakteve lidhur me procedurën e iniciuar disiplinore ndaj saj;
- Kërkesa me e-mail e datës 22.09.2025, nga Lendita Rreba Selimi drejtuar Kryetarit të komisionit disiplinor, lidhur me shqyrtimin e konfliktit të interesit të anëtarëve të komisionit disiplinor, si dhe për përjashtimin e Lavdim Bajrami, Leonora Sylejmani si dhe të vet asaj;

- Vendimi i Komisionit Disiplinor, të datës 20.11.2025, nr. prot.5132/25, me të cilin shqiptohet masa disiplinore ndaj zyrtares Lendita Rreba Selimi, *"Ndalimi i avancimit në kategorinë me të lartë në periudhën prej 5 (pesë) viteve"*, për shkak të refuzimit të kryerjes së detyrave të punës sipas kontratës dhe akteve nënligjore në fuqi si dhe mosbindje ndaj urdhrave të eprorit.

Pas administrimit të provave dhe informacioneve në dispozicion, konstatimit të gjendjes faktike si më lartë, Agjencia ka konstatuar se në rastin konkret *nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin për ekzistimin e situatës së konfliktit të interesit*, në kuptim të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, për zyrtarin Lavdim Bajrami, për faktin se pretendimet e raportuesit lidhur me ofendime, kërcënime dhe marrëdhënie të tensionuara ndër personale nuk janë mbështetur me prova materiale apo dokumente, ndonjë ankesë apo procedurë e iniciuar për sjellje jo etike, të cilat do të mund të konsideroheshin si bazë për konstatimin e interesit privat të zyrtarit lidhur me përfshirjen e tij në çështjen konkrete.

Për më tepër, sipas deklaratës së tij të ofruar për Agjencinë, është mohuar se ekziston ndonjë raport armiqësor ndërmjet tyre, duke theksuar se raporti i tij me znj. Rreba Selimi kanë qenë dhe mbeten korrekte, në kuadër të marrëdhënieve profesionale dhe kolegjiale. Andaj, në kuptim të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, nuk është vërtetuar ekzistenca e interesit privat, si element thelbësor i konfliktit të interesit.

Sipas nenit 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nocioni i konfliktit të interesit është përkufizuar si në vijim:

"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare".

Ndërsa neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, interesin privat e ka përkufizuar si në vijim:

"Interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste",

si dhe me nënparagrafin 1.6 të këtij neni është përkufizuar personi i afërm si në vijim:

"person i afërm me zyrtaren është bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. [...]."

Po ashtu duhet theksuar nenin 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit i cili parasheh si në vijim:

"Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiq nga kjo vendimmarrje."

Pra, në kuptim të dispozitave të sipërcituara, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me procesin e vendimmarrjes apo çasteve paraprake të vendimmarrjes, nën kushtet e ekzistencës së interesit privat të zyrtarit apo të personave të afërm me të, në një çështje të caktuar. Prandaj, për tu konstatuar konflikti i interesit në një çështje të caktuar, duhet të plotësohen kushtet thelbësore (kumulative) të tij, siç është vendimmarrja apo çastet paraprake të vendimmarrjes si dhe interesi privat i zyrtarit ose i personave të afërm me zyrtaren.

Në këtë rast, nga provat e administruara nuk janë gjetur rrethana faktike që vërtetojnë interesin privat të zyrtarit z. Lavdim Bajrami, se i njëjti ka pasur ndonjë raport armiqësor apo interes tjetër jashtë raportit profesional të punës, i cili raport mund të ketë ndikuar në objektivitetin apo paanshmërinë në vendimmarrjen e tij në kuadër të komisionit disiplinor. Rrjedhimisht, duke qenë se mungon një nga elementet thelbësore-interesi privat, nuk plotësohen kushtet kumulative për ekzistimin e konfliktit të interesit sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka trajtuar rastin në fjalë në kuadër të kompetencave të saj ligjore, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, duke u fokusuar ekskluzivisht në aspektet që ndërlidhen me konfliktin e interesit, pa hyrë në shqyrtimin e çështjeve të tjera juridike që i përkasin kompetencës së institucioneve të tjera shtetërore.

II. Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: “Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë”, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: “Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur ka të drejtë të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendim iu dërgohet:

- Palës Lavdim Bajrami dhe palës/ve tjera procedurale
- Drejtorit të DPKI-së
- Zyrtarit përgjegjës (bartësit të lëndës)

Yll BULESHKAI
Drejtör i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

